

# Kushtet e Përdorimit për Rent From Locals

*Përditësuar më: 4 Korrik 2024*

Mirë se vini në Rent From Locals, tregun kryesor online për marrjen me qira të makinave në Shqipëri dhe rajonet përreth. Duke hyrë në faqen tonë të internetit dhe duke përdorur shërbimet tona, ju pranoni të respektoni dhe të jeni të lidhur me Kushtet e Shërbimit të mëposhtme. Ju lutemi t'i shqyrtoni me kujdes.

Këto Kushte të Shërbimit ("Marrëveshja") përbëjnë një marrëveshje ligjore të detyrueshme midis jush dhe Localweb, që rregullon të drejtat dhe detyrimet tuaja gjatë përdorimit të faqes së internetit, aplikacionit dhe shërbimeve të ofruara nga Rent From Locals.

Rent From Locals funksionon përmes faqes së internetit [www.rentfromlocals.al](http://www.rentfromlocals.al) ("Platforma"), duke lehtësuar marrjen me qira të mjeteve midis Përdoruesve. Përdoruesit që rendisin dhe ofrojnë makina për qira quhen "Pronari," ndërsa ata që kërkojnë ose marrin me qira një makinë quhen "Klienti." Localweb, si ofrues i Platformës, nuk zotëron, kontrollon, ofron apo menaxhon asnjë nga mjetet e renditura. Localweb nuk funksionon si agjenci për qira makine, agjenci udhëtimesh apo sigurues. Për më tepër, Localweb nuk vepron si agjent për Përdoruesit, përveç nëse deklarohet shprehimisht në këtë marrëveshje. Kur një rezervim pranohet, si Pronari ashtu edhe Klienti hyjnë në një kontratë direkt me njëri-tjetrin; Localweb nuk është palë në këtë kontratë.

Platforma 'Rent From Locals' është në pronësi të Localweb, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas ligjit shqiptar me NUIS M41312032J dhe me seli në Tiranë.

Në këtë marrëveshje, termat "Rent From Locals," "Localweb", "Kompania," "Ne," "Neve," dhe "Jona" i referohen entitetit të mësipërm.

"Palë" ose "Palët" i referohen të dyve, Përdoruesve dhe Rent from Locals.

## 1. Kushtet për Klientët

### 1.1 Rezervimi.

Kur rezervoni një makinë me qira, ju pranoni të paguani të gjitha tarifat për rezervimin tuaj, përfshirë çmimin e qirasë, tarifat e komisionit të Platformës dhe një depozitë garancie në rast mos-paraqitjeje, nëse kjo kërkohet nga Pronari. Nëse zgjidhni të paguani në një monedhë të ndryshme nga monedha e përcaktuar nga Pronarët për Makinat me Qira, çmimi që ju shfaqet bazohet në një kurs këmbimi të përcaktuar nga ne.

Me marrjen e konfirmimit për rezervimin e kryer, një marrëveshje për Shërbimet e Qirasë ("Rezervimi") lidhet drejtëpërdrejtë mes jush dhe Pronarit. Rent From Locals shërben si një platformë për të lehtësuar këto marrëveshje por nuk është palë në to. Duke bërë një Rezervim, ju pranoni kushtet e marrëveshjes të cilat përfshijnë këto Kushte Përdorimi, të gjitha kushtet e Marrëveshjes së Qirasë, duke përfshirë, pa kufizim, politikën e anulimit dhe çdo rregull, standard, politikë ose kërkesë tjetër të identifikuar në atë marrëveshje. Përdoruesit janë përgjegjës për të siguruar që të gjitha kushtet e Marrëveshjes së Qirasë të përmbushen dhe duhet t'i lexojnë me kujdes këto kushte përpara se të finalizojnë çdo marrëveshje.

## **1.2 Anulimet dhe Rimbursimet.**

Në përgjithësi, nëse anuloni një Rezervim ose nuk paraqiteni, shuma e rimbursueshme për ju përcaktohet nga politika e anulimit ose mos-paraqitjes që Pronari ka vendosur për atë Rezervim. Nëse një anulim ndodh përpara afatit të specifikuar, si tarifat e shërbimit ashtu edhe çdo garanci e vendosur e kërkuar nga pronari, janë plotësisht të rimbursueshme.

Nëse një Pronar anulon rezervimin para se të fillojë qiraja juaj, do të keni të drejtën të anuloni rezervimin dhe të kërkonit një rimbursim të plotë (pavarësisht sa afër është fillimi i qirasë tuaj) por ne nuk do të kemi asnjë përgjegjësi shtesë për ndonjë kosto direkte ose indirekte që mund të keni (p.sh. dhoma hoteli ose taksi).

Kohëzgjatja e procesit të rimbursimit mund të variojë, rreth disa javë, në varësi të politikave të bankës së qiramarrësit me të cilën është realizuar pagesa.

Rent From Locals nuk do të jetë përgjegjës për asnjë komision, humbje që rezulton nga luhatjet e kursit të këmbimit, apo çdo shumë tjetër që mund të mbahet nga llogaria juaj. Kjo përfshin, por nuk kufizohet vetëm në, çdo tarifë ose kosto të vendosur nga palët e treta, institucionet financiare ose autoritetet rregullatore gjatë kryerjes së rimbursimit. Ju merrni përsipër të gjitha risqet që lidhen me këto mbajtje të mundshme dhe pranoni që ne nuk kemi asnjë kontroll mbi këta faktorë të jashtëm.

## **1.3 Ndryshimet në Rezervim.**

Klientët dhe Pronarët janë përgjegjës për çdo ndryshim në rezervim që bien dakord të bëjnë përmes Platformës Rent From Locals dhe pranojnë të paguajnë çdo shumë shtesë, tarifë ose taksë të lidhur me çdo ndryshim në rezervim.

## **1.4 Përgjegjësitë e Klientit dhe marrja përsipër e Rrezikut.**

Ju jeni përgjegjës për veprimet dhe mosveprimet tuaja, si dhe për veprimet dhe mosveprimet e kujt do që ftoni të bashkohet ose i siguronit akses në makinat e marra me qira.

Ju pranoni që shumë veprimtari mbartin natyrshëm rreziqe dhe bini dakord që, për sa lejohet nga ligji i zbatueshëm, të merrni përsipër gjithë rrezikun që mund të vijë nga aksesimi dhe

përdorimi i Platformës Rent From Locals. Kjo do të thotë se është përgjegjësia juaj të kqyrni automjetin e rezervuar për qira në pikën e marrjes për të përcaktuar nëse është i përshtatshëm për ju. Rent From Locals nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë pasojë që mund të vijë nga shfaqja e këtyre rreziqeve.

## **2. Kushtet për Pronarët**

### **2.1 Pronarët.**

Si Pronar, Rent From Locals ju ofron të drejtën për të përdorur Platformën tonë për të listuar, promovuar automjete për qira dhe për të fituar para duke e bërë këtë. Platforma jonë ju mundëson të promovoni dhe të jepni me qira automjete të listuara, të vendosni çmimin tuaj, disponueshmërinë dhe rregullat për secilin automjet.

Kur pranoni një kërkesë për rezervim, ose merrni një konfirmim të rezervimit përmes Platformës Rent From Locals, ju hyni në një marrëveshje direkt me Klientin dhe jeni përgjegjës për ofrimin e Shërbimit sipas kushteve dhe çmimit të specifikuar në Listimin tuaj. Ju gjithashtu bini dakord që të paguani komisionin përkatës për çdo rezervim. Rent From Locals do të zbresë tarifën e komisionit nga shumata e paguara nga Klientët përmes Platformës tonë, përveç kur palët do të bien dakord për një metodë tjetër pagimi. Çdo term ose kusht që do të përfshini në marrëveshjen me Klientët duhet të jetë: (i) në përputhje me këto Kushte Përdorimi, me Politikën tonë, dhe me informacionin e dhënë në Listimin tuaj, dhe (ii) të jetë qartësisht i parashikuar në përshkrimin e Listimit tuaj.

### **2.2 Marrëdhënia e Pavarur Kontraktuale.**

Marrëdhënia juaj me Rent From Locals është ajo e një individi ose entiteti të pavarur dhe jo e një punonjësi, agjenti, sipërmarrësi ose partneri, dhe asnjëra palë nuk do të ketë asnjë të drejtë për të marrë përsipër ndonjë detyrim në emër të pales tjetër.

### **2.3 Listimet e Automjeteve**

Pronarët janë të detyruar të listojnë automjetet e tyre me saktësi, duke përfshirë përshkrime të detajuara të markës, modelit, moshës, gjendjes së automjetit, çmimin, tarifën shtesë siç janë tarifën e sigurimit, mbulimi i karburantit si dhe çdo term ose kufizim specifik që lidhet me Klientin ose automjetin. Pronarët janë përgjegjës për veprimet ose mosveprimet e tyre si dhe për mbajtjen e informacionit të automjetit të tyre (përfshirë disponueshmërinë e kalendarit) dhe përmbajtjen (si fotot) të përditësuara dhe të sakta në çdo kohë. Të gjitha automjetet e listuara duhet të jenë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret vendase, duke përfshirë standardet e sigurisë dhe emisioneve (shkarkimeve). Pronarët gjithashtu duhet të ofrojnë dëshmi të sigurimit të automjetit, si dhe një përshkrim të detajuar të paketës së sigurimit dhe opsioneve shtesë.

### **2.4 Njohja e Detyrimeve Ligjore.**

Ju jeni përgjegjës për njohjen dhe respektimin e të gjitha ligjeve, rregullave, rregulloreve dhe marrëveshjeve me palët e treta që zbatohen për Listat tuaja të automjeteve ose Shërbimet e Qirasë. Për shembull: disa Shtete kërkojnë që Pronarët të regjistrohen, të marrin një leje ose të marrin një licencë përpara se të ofrojnë shërbime të caktuara të qirasë. Informacioni që ne ofrojmë lidhur me kërkesat ligjore është vetëm për qëllime informimi dhe ju duhet të informoheni në mënyrë të pavarur për detyrimet tuaja. Ju jeni përgjegjës për trajtimin dhe përdorimin e të dhënave personale të Klientëve dhe të tjerëve në përputhje me ligjet e zbatueshme për privatësinë dhe këto Kushte Përdorimi, përfshirë edhe Politikën tonë të Privatësisë.

Ju jeni përgjegjës për veprimet dhe mosveprimet tuaja si dhe për veprimet dhe mosveprimet e kujtdo që lejoni të marrë pjesë në ofrimin e Shërbimeve tuaja të Qirasë. Ju jeni përgjegjës për vendosjen e çmimit dhe përcaktimin e rregullave dhe kërkesave për Listimet tuaja të Automjeteve. Ju duhet të përshkruani çdo tarifë dhe kosto shtesë në përshkrimin e Listimit tuaj dhe nuk mund të kërkonit asnjë tarifë ose kosto shtesë jashtë atyre të dhëna në Platformën Rent From Locals.

## **2.5 Ndryshimet në Rezervim.**

Klientët dhe Pronarët janë përgjegjës për çdo ndryshim në rezervim që bien dakord të bëjnë përmes Platformës Rent From Locals dhe pranojnë të paguajnë çdo shumë shtesë, tarifë ose taksë të lidhur me çdo ndryshim në rezervim.

## **2.6 Taksat**

Si Pronar, ju jeni përgjegjës për përcaktimin dhe përmbushjen e detyrimeve tuaja sipas ligjeve të aplikueshme për raportimin, mbledhjen, dorëzimin ose përfshirjen në çmimin tuaj të TVSH, Tatimit mbi të ardhurat ose taksa të tjera të tërthorta ("Taksat").

Në disa Shtete, parashikimet ligjore mbi taksat mund të kërkojnë që ne të mbledhim dhe/ose raportojmë informacionin tatimor rreth jush. Nëse një informacion i tillë kërkohet nga ndonjë autoritet tatimor ose autoritet tjetër shtetëror, ne do ta ofrojmë menjëherë atë si dhe do t'ju informojmë për të përmbushur detyrimin përkatës që buron nga shërbimet e Qirasë.

## **2.7 Anullimet e rezervimeve.**

Në përgjithësi, nëse një Klient anulon një Rezervim, shuma e paguar për ju përcaktohet nga politika e anulimit, depozita e garancisë eventuale e kërkuar dhe kushtet e pagesës që zbatohen për atë Rezervim.

## **3. KUSHTET E PËRGJITHSHME**

### 3.1 Kushtet e Llogarisë

Për të aksesuar disa komponent të caktuar të platformës tonë, përdoruesit duhet të regjistrojnë një llogari. Regjistrimi lejohet vetëm për persona juridik, shoqëri dhe persona fizikë që janë të paktën 18 vjeç.

Ne rezervojmë të drejtën të refuzojmë shërbimin për këdo, për çdo arsye dhe në çdo kohë.

Ju pranoni që të paraqisni informacion të saktë dhe të plotë gjatë procesit të regjistrimit dhe të përditësoni profilin tuaj për ta mbajtur atë të saktë, të përditësuar dhe të plotë. Ne rezervojmë të drejtën të pezullojmë ose të ndërpresim llogaritë që kanë informacion të pasaktë ose të paplotë.

Ju jeni përgjegjës për ruajtjen e konfidencialitetit dhe sigurisë së kredencialeve të llogarisë tuaj dhe për këtë arsye jeni përgjegjës për veprimtaritë e kryera përmes llogarisë tuaj. Nëse dyshoni se llogaria juaj është kompromentuar në ndonjë mënyrë, duhet të njoftoni menjëherë Rent From Locals për të pezulluar ose ndërprerë llogarinë.

Ju jeni përgjegjës për të gjithë aktivitetin dhe përmbajtjen e llogarisë si fotografitë, imazhet, videot, përmbajtjen e shkruar, informacionin ose të dhënat e ngarkuara, të mbledhura, të gjeneruara, të ruajtura, të shfaqura, të shpërndara, të transmetuara ose të ekspozuara në ose në lidhje me llogarinë tuaj.

Një shkelje ose mospërbushje e ndonjë prej Kushteve të Përdorimit, përfshirë Politikën e Privatësisë, mund të çojë në ndërprerjen e menjëhershme të Shërbimeve tuaja, bazuar në vendimarrjen dhe diskrecionin e Rent From Locals.

### 3.2 Kufizim i Garancive

**Statusi i Mos-Garantuesit.** Rent From Locals shprehimisht deklaron se nuk do të ketë asnjë rol si garantues ose sigures për ndonjë përdorues ose automjet të listuar në platformën e tij. Kjo do të thotë që Rent From Locals nuk merr asnjë përgjegjësi financiare ose ligjore për performancën, sjelljen, ose gjendjen e përdoruesve ose automjeteve të përfshira në ndonjë transaksion ose ndërveprim të kryer përmes shërbimeve të tij.

**Saktësia e Informacionit:** Përdoruesit janë përgjegjës e vetëm për të siguruar që të gjitha informacionet që ata paraqesin në platformën Rent From Locals janë të sakta, të plota dhe të përditësuar. Kjo përfshin, por nuk është e kufizuar në, informacionin rreth identitetit të tyre, detajet e kontaktit, specifikimet e automjeteve, dhe çdo e dhënë tjetër e nevojshme.

**Pasojat e paraqitjes së gabuar:** Përdoruesit pranojnë se çdo paraqitje e gabuar, falsifikim, ose mangësi në informacion mund të rezultojë në pasoja ligjore, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, pezullimin ose ndërprerjen e llogarisë së tyre, si dhe veprime të mundshme ligjore nga palët e prekura.

**Mosdhënia e Deklaratave ose Konfirmimeve:** Rent From Locals nuk jep asnjë deklaratë, konfirmim, garanci ose miratim në lidhje me saktësinë, besueshmërinë, ose autenticitetin e informacionit të dhënë nga përdoruesit. Kjo përfshin, por pa u kufizuar në, identitetet e përdoruesve, historikun e tyre, ose gjendjen dhe pronësinë e automjeteve.

Rent From Locals nuk kryen kontrolle historike, verifikime identiteti, ose ndonjë formë tjetër të kontrollit të përdoruesve. Përdoruesit janë përgjegjësit e vetëm për të patur kujdesin e duhur përpara se të angazhohen në ndonjë transaksion ose ndërveprim. Përdoruesit inkurajohen të tregojnë kujdes dhe të kryejnë një verifikim të plotë kur ndërveprojnë me përdorues të tjerë ose angazhohen në transaksione. Kjo përfshin verifikimin e identitetit, historikun, dhe besueshmërinë e palëve të tjera në mënyrën më të mirë të mundshme.

**Mungesa e përgjegjësisë për Veprimet e Përdoruesve:** Rent From Locals nuk do të mbajë përgjegjësi për asnjë pasaktësi, paraqitje të gabuar, ose mangësi të përdoruesit, dhe as për ndonjë dëm ose humbje që mund të shkaktohet nga mbështetja e përdoruesve në informacionin e dhënë nga të tretët në platformë.

Përdoruesit bien dakord të dëmshpërblejnë dhe të mbajnë të padëmtuar Rent From Locals nga çdo kërkesë, humbje, dëm, ose shpenzim që mund të lind nga ose lidhet me mbështetjen e tyre në informacionin e dhënë nga përdorues të tjerë në platform ose mosverifikimi nga ana e tyre të këtij informacioni.

**Mungesa e garancisë për aftësinë paguese:** Rent From Locals deklaron qartazi se nuk mund të garantojë aftësinë paguese ose kredibilitetin financiar të ndonjë përdoruesi, përfshirë qiramarrësit. Përdoruesit janë përgjegjës për vlerësimin e besueshmërisë financiare të kontakteve të tyre në mënyrë të pavarur.

**Verifikimi i Identitetit dhe Dokumenteve:** Përdoruesit janë përgjegjës për verifikimin e identitetit të kontakteve të tyre, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, kontrollimin e dokumenteve të automjetit dhe patentën e drejtimit të qiramarrësit në momentin e dorëzimit të automjetit. Rent From Locals rekomandon që përdoruesit të marrin të gjitha masat e nevojshme për të garantuar autenticitetin dhe vlefshmërinë e këtyre dokumenteve.

**Verifikimi i të dhënave:** Rent From Locals rezervon të drejtën, sipas diskrecionit të tij dhe deri në masën e lejuar nga ligji i zbatueshëm, të verifikojë të dhënat e një përdoruesi nëse ka informacion të mjaftueshëm për të identifikuar një përdorues të tillë. Kjo vendimmarrje synon të përmirësojë cilësinë e shërbimit, por nuk mund të garantohet për të gjithë përdoruesit. Përdoruesit pranojnë dhe bien dakord që Rent From Locals nuk është i detyruar të kryejë kontrolle të të dhënave të përdoruesve të tij. Kur Rent From Locals zgjedh të kryejë një verifikim të tillë, bëhet për të ofruar kushte më të mira të shërbimit dhe nuk nënkupton asnjë garantim të besueshmërisë së përdoruesit të verifikuar.

**Pajtueshmëria e Përdoruesve me Ligjet vendase:** Rent From Locals nuk është përgjegjës për të siguruar pajtueshmërinë e përdoruesve me ligjet dhe rregulloret vendase, duke përfshirë, por pa

u kufizuara në, legjislacionin mbi taksat, turizmin dhe qiradhënien. Përdoruesit janë përgjegjësit e vetëm për të njohur dhe respektuar legjislacionin vendas të zbatueshëm. Rent From Locals nuk ka asnjë përgjegjësi për ndonjë veprim, mosveprim, ose mos-përmbushje nga përdoruesit, të ndonjë detyrimi financiar, kërkesë ligjore apo cdo detyrimi tjetër.

### **3.3. Marrëveshjet e Qirasë**

Marrëveshjet e qirasë janë kontrata të drejtpërdrejta midis Pronarëve dhe Klientëve. Rent From Locals shërben si një platformë për të mundësuar këto marrëveshje, por nuk është palë në to. Përdoruesit janë përgjegjës për përmbushjen e të gjitha kushteve të marrëveshjes së qirasë dhe duhet t'i shqyrtojnë me kujdes ato përpara se të finalizojnë çdo marrëveshje.

Platforma jonë nuk rekomandon apo garanton asnjë nga Ofruesit e Shërbimit, produktet e tij, shërbimet, pajisjet, automjetet etj.

Ne nuk jemi palë në kushtet midis jush dhe Ofruesit të Shërbimit. Ofruesi i Shërbimit është përgjegjësi i vetëm për Udhëtimin.

### **3.4. Vlerësimet**

Pas secilës qiradhënie, Pronarët dhe Klientët do të kenë mundësinë të vlerësojnë njëri-tjetrin. Vlerësimi juaj duhet të jetë i saktë dhe nuk duhet të përmbajë gjuhë diskriminuese, fyese, shpifëse, ose ndonjë gjuhë të papërshtatshme që shkel këto Kushte Përdorimi ose ndonjë ligj të zbatueshëm. Vlerësimet nuk verifikohen nga Rent From Locals për saktësinë dhe mund të jenë të pasakta ose mashtruese.

### **3.5. Tarifët dhe Pagesat**

Shërbimi ynë tarifon një komision për çdo transaksion qiradhënieje. Normat specifike të komisionit dhe detajet e tarifave janë të përshkruara në strukturën tonë të tarifimit, e cila është e disponueshme në faqen tonë të internetit dhe e aksesueshme për të gjithë përdoruesit para se të bëjnë një rezervim.

Të gjitha pagesat përpunohen përmes sistemit tonë të sigurt të pagesave online, duke siguruar sigurinë dhe konfidencialitetin e informacionit financiar të përdoruesve.

Në momentin e konfirmimit të rezervimit, qiramarrësit do të ngarkohen me tarifën e shërbimit të zbatueshme plus një shumë garancie të rimbursueshme. Tarifën e shërbimit mbulojnë koston e përdorimit të platformës sonë dhe sigurimin e përpunimit të qetë të transaksioneve.

Pronari do të marrë pagesën e qirasë direkt nga qiramarrësi në kohën e dorëzimit të makinës dhe para fillimit të periudhës së qirasë. Kjo siguron që pronarët të marrin pagesën e tyre paraprakisht, duke ofruar siguri financiare para se automjeti të dorëzohet.

**Shuma e Garancisë:** Pronarët rezervojnë të drejtën të kërkojnë një shumë garancie si pjesë e procesit të rezervimit. Kjo garanci mbahet nga Rent From Locals derisa makina të merret nga qiramarrësi. Garancia shërben si mbrojtje për pronarin kundër rasteve të mos-paraqitjes së qiramarrësit. Pas marrjes së makinës nga qiramarrësi, shumta e garancisë i rimbursohet qiramarrësit menjëherë për të siguruar që fondet e qiramarrësit të kthehen mbrapsht në kohë.

Në rastet kur qiramarrësi nuk paraqitet dhe nuk ka anuluar rezervimin brenda afatit të specifikuar, shumta e garancisë, minus çdo tarifë transferimi të zbatueshme, i transferohet pronarit për të kompensuar shqetësimin dhe humbjen e mundshme të të ardhurave nga qiraja.

Nëse metoda juaj e pagesës është në një monedhë të ndryshme nga monedha e kërkuar e pagesës, banka juaj ose ofruesi i metodës së pagesës mund t'ju ngarkojnë me tarifa shtesë. Për shembull, nëse karta juaj e kreditit është në Euro, por qiradhënësi ju tarifon në dollarë. Në këtë rast, ne do t'ju informojmë gjatë procesit të rezervimit.

### 3.6. Sigurimi

Paketat e sigurimit të makinave tek Rent From Locals ofrohen nga Pronari. Pronari është përgjegjës që makina të ketë sigurimin minimal të kërkuar me ligj, si dhe të përshkruajë saktësisht paketën e sigurimit dhe opsionet e ofruara. Rent From Locals nuk ofron asnjë produkt sigurimi vetë, por ofron një kornizë të caktuar për përshkrimin e duhur të sigurimit që përfshihet dhe të opsioneve shtesë të sigurimit. Në rast se përshkrimi i ofruar nga pronari nuk është i qartë, Rent From Locals sugjeron që qiramarrësi të kontaktojë Pronarin direkt përmes platformës me anë të mesazheve për më shumë detaje.

Konceptet e mëposhtme përfshihen në përshkrimin e automjeteve:

**a) Sigurimi i përfshirë:** Kjo është pjesë e çmimit të qirasë dhe ka dy lloje:

**i) Sigurimi bazë:** I detyrueshëm me ligj dhe gjithmonë i përfshirë në tarifën bazë.

**ii) Paketë gjithpërfshirëse:** Ofron mbrojtje shtesë në rast aksidentesh, zakonisht kundrejt një tarife shtesë të paguar nga qiramarrësi.

**b) Sigurimi Extra:** I disponueshëm për një tarifë shtesë ditore, ofron:

**i) Ulja e shumës së zbritshme:** Ul shumën e zbritshme për një tarifë shtesë ditore, duke specifikuar shumën e re, të ulur.

**ii) Sigurimi i plotë (Super CDW):** Eliminon tërësisht shumën e zbritshme.

### 3.7 Kufizimi i Përgjegjësisë

Ju njihni dhe pranoni shprehimisht se, për sa lejohet nga legjislacioni i zbatueshëm, Rent from Locals nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë dëm të drejtpërdrejtë, të tërthortë, incidental, të



veçantë, i rrjedhur ose direkt, duke përfshirë por pa u kufizuar në, dëme të ardhura nga humbja e fitimeve, reputacionit, përdorimit, të dhënat ose humbjeve të tjera të tërthorta që mund të vijnë nga përdorimi ose pamundësia për të përdorur Shërbimin.

Në masën e lejuar nga ligjet e zbatueshme, në asnjë rast Rent from Locals nuk do të jetë përgjegjës për humbje të fitimeve ose ndonjë dëmtim të veçantë, incidental ose direkt, që vjen nga apo në lidhje me, faqen tonë, Shërbimet tona ose këto Kushte të Përdorimit (pavarësisht nëse janë me dashje apo nga pakujdesia). Ju pranoni të dëmshpërbleni dhe të mbani të padëmtuar Rent from Locals dhe (sipas rastit) degët, partnerët, oficerët, drejtorët, agjentët, punonjësit dhe furnizuesit tanë nga çdo pretendim ose kërkesë, përfshirë tarifat e arsyeshme të avokatëve, të bërë nga ndonjë palë e tretë për shkak të ose që rrjedh nga shkelja juaj e këtyre Kushteve të Përdorimit, ose nga shkelja juaj ligjit apo të drejtave të një pale të tretë.

Përdoruesit pranojnë dhe bien dakord që në rastet kur dëmi ose cënimi i ndodhur, i atribuohet veprimeve ose mosveprimeve të një përdoruesi tjetër ose një pale të tretë, përgjegjësia për dëmin ose cënimin e ardhur i takon vetëm palës që e ka shkaktuar drejtpërdrejt atë.

Përdoruesit bien dakord të ndjekin çdo kërkesë, pretendim, ose veprim ligjor ekskluzivisht kundër individit ose entitetit përgjegjës për shkakimin e dëmit. Përdoruesit nuk do të ndër marrin asnjë procedurë ligjore ose kërkesë kundër Rent From Locals në lidhje me incidente të tilla.

Përdorimi i Shërbimeve është në rrezikun tuaj të vetëm. Shërbimet ofrohen "siç janë" dhe "siç janë të disponueshme" pa asnjë garanci ose kusht të shprehur, të nënkuptuar ose ligjor.

Rent from Locals nuk garanton se Shërbimet do të jenë të pandërprera, në kohë, të sigurta ose pa gabime.

Rent from Locals nuk garanton se rezultatet që mund të arrihen nga përdorimi i Shërbimeve do të jenë të sakta ose të besueshme.

Rent from Locals nuk garanton se cilësia e automjetit, shërbimi, informacioni i marrë nga ju përmes Platformës do të përmbushë pritshmëritë tuaja, ose se ndonjë gabim në Shërbimet e dhëna do të korrigjohet.

### **3.8 Sjellja dhe Përgjegjësitë e Përdoruesit**

Përdoruesit duhet të sillen në mënyrë të ligjshme dhe të respektueshme. Sjellja diskriminuese, aktivitetet e paligjshme dhe çdo formë ngacmimi janë rreptësisht të ndaluara. Përdoruesit duhet të respektojnë të drejtat dhe pasuritë e të tjerëve dhe t'u përmbahen të gjitha kushteve të marrëveshjes së qirasë.

Nëse ju shkelni këto Kushte Përdorimi ose nuk respektoni ligjet ose rregulloret e zbatueshme, ne kemi të drejtën, me ose pa lajmërim paraprak, të:

- pezullojmë ose kufizojmë aksesin tuaj në përdorimin e Platformës dhe/ose llogarinë tuaj;

- pezullojmë, heqim, çaktivizojmë ose kufizojmë vizibilitetin e Listimeve, vlerësimeve, ose përmbajtjeve të tjera;
- anulojmë rezervimet në pritje ose të konfirmuara;

Për shkelje të vogla ose kur është e përshtatshme sipas vlerësimit diskrecional të Rent from Locals, ne do t'ju njoftojmë për çdo masë që do të marrim si dhe një mundësi për të rregulluar shkeljen. Ju mund të kundërshtoni veprimet e ndërmarra nga ana jonë sipas këtij paragrafi duke kontaktuar shërbimin për klientin.

Nëse ne anulojmë një Rezervim si rezultat të sa më sipër, mund të mos keni të drejtë për një rimbursim (në varësi të rrethanave). Ne mund t'ju bëjmë me dije shkaqet pse kemi anuluar Rezervimin tuaj, përveç kur dhënia e tyre do të përbënte (a) shkelje të ligjeve të zbatueshme dhe/ose (b) do të ndalojë apo pengojë zbulimin ose parandalimin e mashtrimit ose aktiviteteve të tjera të paligjshme. Nëse besoni se kemi anuluar gabimisht Rezervimin tuaj, ju lutemi kontaktoni ekipin tonë të Shërbimit për Klientin.

### **3.9 Të Drejtat e Pronësisë Intellektuale**

Përveçse kur parashikohet ndryshe, të gjitha të drejtat në Platformën tonë (teknologjia, përmbajtja, markat tregtare, pamja dhe ndjesia, etj.) janë në pronësi të Localweb dhe duke përdorur Platformën tonë ju pranoni ta përdorni atë vetëm për qëllimin për të cilën është krijuar dhe duke respektuar kërkesat e përcaktuara më poshtë.

Ju nuk lejohet të monitoroni, kopjoni, nxirrni/kërkoni të dhëna, shkarkoni, riprodhoni ose përdorni ndonjë gjë nga Platforma jonë për ndonjë qëllim komercial pa miratimin me shkrim të Localweb.

### **3.10 Kohëzgjatja**

Marrëveshja midis jush dhe Rent from Locals e reflektuar nga këto Kushte është efektive nga momenti kur ju aksesoni në Platformën tonë (për shembull për të krijuar një llogari) dhe mbetet në fuqi derisa ju ose ne të përfundojmë marrëveshjen në përputhje me këto Kushte.

### **3.11 Përfundimi**

Ju mund të përfundoni këtë marrëveshje në çdo kohë duke na dërguar një email ose duke fshirë llogarinë tuaj. Rent from Locals mund të përfundojë këtë marrëveshje dhe llogarinë tuaj për çfarëdolloj arsye duke ju dhënë 30 ditë njoftim përmes emailit ose duke përdorur ndonjë mënyrë tjetër kontakti të dhënë për llogarinë tuaj.

Rent from Locals gjithashtu mund të përfundojë këtë marrëveshje menjëherë dhe pa njoftim dhe të ndalojë ofrimin e aksesit në Platformën tonë nëse ju shkelni këto Kushte, Politikat tona ose shkelni ligjet e zbatueshme gjatë periudhës së shërbimit. Nëse llogaria juaj ka qenë joaktive për më shumë se dy vjet, ne mund të mbyllim llogarinë tuaj pa njoftim paraprak.

### **3.12 Efekti i Përfundimit**

Nëse jeni Pronar dhe mbyllni llogarinë tuaj në Rent from Locals, çdo rezervim i konfirmuar do të anulohet automatikisht dhe Klientët tuaj do të marrin një rimbursim të plotë. Nëse mbyllni llogarinë tuaj si Klient, çdo rezervim i konfirmuar do të anulohet automatikisht dhe çdo rimbursim do të varet nga kushtet e politikës së anulimit të Rezervimit. Kur kjo marrëveshje të ketë përfunduar, ju nuk keni të drejtë të recuperoni llogarinë tuaj ose ndonjë prej Përmbajtjeve në të. Nëse aksesit juaj në ose përdorimi i Platformës Rent from Locals është kufizuar, ose nëse llogaria juaj në Rent from Locals është pezulluar, ose kjo marrëveshje është zgjidhur nga ne, ju nuk mund të regjistroni një llogari të re ose të përdorni Platformën tonë përmes një llogarie të një Anëtarit tjetër.

### **3.13 Forca Madhore**

Rent From Locals nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë vonesë ose dështim në performancë që rezulton nga rrethana të pazakonta ose të paparashikueshme jashtë kontrollit të tij të arsyeshëm, pasojat e të cilave do të kishin qenë të pashmangshme pavarësisht të gjitha përpjekjeve tona, përfshirë, por pa u kufizuar në, veprat e Zotit, fatkeqësitë natyrore, luftën, terrorizmin, trazirat, embargo, veprimet e autoriteteve civile ose ushtarake, zjarrin, përmytjet, aksidentet, pandemitë, epidemitë ose sëmundjet, grevat ose kufizimet e mjeteve të transportit, karburantit, energjisë, punës ose materialeve.

### **3.14 Klauzola e Modifikimit**

Rent From Locals rezervon të drejtën të modifikojë këto Kushte të Përdorimit në çdo kohë. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi menjëherë pas publikimit në faqen tonë të internetit. Përdoruesit do të njoftohen për ndryshimet e rëndësishme përmes faqes sonë të internetit ose përmes emailit.

Nëse këto ndryshime janë të qënësishme, ne do t'ju informojmë paraprakisht para se të hyjnë në fuqi, përveç nëse ndryshimet kërkohen nga ligji i zbatueshëm.

Nëse nuk i pranoni ndryshimet, ju lutemi mos përdorni Platformën tonë. Përndryshe, përdorimi juaj i vazhdueshëm i Platformës sonë pas datës së hyrjes në fuqi të ndryshimeve të propozuara do të përbëjë pranim nga ana juaj të Kushteve të rishikuara.

Çdo Rezervim ekzistues do të vazhdojë të rregullohet nga Kushtet që ishin në fuqi në kohën kur Rezervimi është bërë.

### **3.15 Të Ndryshme**

Të gjitha kushtet dhe parashikimet e Kushteve të Përdorimit do të jenë të detyrueshme dhe do të krijojnë të drejta për palët në këtë marrëveshje, si dhe për trashëgimtarët, pasardhësit, të autorizuarit dhe përfaqësuesit ligjorë të tyre. Ju nuk keni të drejtë të autorizoni apo transferoni këto Kushte Përdorimi, ose të drejtat apo detyrimet tuaja në këtë marrëveshje, tek ndonjë palë

e tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Rent from Locals, që mund të jepet ose të refuzohet sipas diskrecionin të saj.

Kur kryeni Rezervimin tuaj, ju pranoni këto Kushte Përdorimi dhe çdo kusht tjetër që ju është dhënë gjatë procesit të rezervimit.

Nëse ndonjë kaluzolë, ose pjesë e kaluzolës, në këto Kushte Përdorimi është, për ndonjë arsye, e pavlefshme, e paligjshme ose e pazbatueshme në ndonjë aspekt, atëherë kjo pavlefshmëri, paligjshmëri ose pazbatueshmëri nuk do të ndikojë në klauzolat e tjera (ose pjesën e pa prekur të klauzolës) të Kushteve të Përdorimit, dhe Kushtet e Përdorimit do të interpretohen sikur kjo klauzolë e pavlefshme, e paligjshme ose e pazbatueshme, ose pjesë e kaluzolës, nuk ka qenë kurrë e përfshirë brenda Kushteve të Përdorimit.

Versioni në anglisht i këtyre Kushteve është origjinali. Nëse ka ndonjë mosmarrëveshje rreth Kushteve, ose ndonjë mospërputhje midis Kushteve në anglisht dhe në një gjuhë tjetër, Kushtet në gjuhën angleze do të prevalojnë.

### **3.16 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Në rast të një mosmarrëveshjeje midis Përdoruesve, ekipi ynë i shërbimit për klientët do të lehtësojë përpjekjet për gjetjen e një zgjidhje me mirëkuptim. Pavarësisht se synimi jonë është të ndihmojmë në arritjen e zgjidhjeve me mirëkuptim, vendimet e marra gjatë kësaj mënyre të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nuk janë ligjërisht të detyrueshme. Përdoruesit mund të kërkojnë zgjidhje përmes veprimeve ligjore bazuar në ligjin e zbatueshëm dhe juridiksionin e parashikuar në marrëveshjen e qirasë.

### **3.17 Ligji i Zbatueshëm dhe Juridiksioni**

**Ligji i zbatueshëm:** Këto Kushte Përdorimi, si dhe çdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me to, do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht konflikteve të mundshme mes parimeve të së drejtës.

**Juridiksioni:** Palët bien dakord në mënyrë të përvokueshme se gjykatat shqiptare do të kenë juridiksion ekskluziv për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje ose pretendim (përfshirë mosmarrëveshjet ose pretendimet jo-kontraktuale) që lindin nga ose në lidhje me këto Kushte Përdorimi, ose objektin apo ndërtimin e tyre.

### **3.18 Të dhënat e Kontaktit**

Për ndonjë pyetje ose shqetësim në lidhje me këto Kushte Përdorimi, ju lutemi na kontaktoni në [info@rentfromlocals.com](mailto:info@rentfromlocals.com).